

TEUTA NUNAJ

Grada: Doktor i Shkencave Ekonomike

Fusha e ekspertizës kërkimore: Menaxhimi, Administrimi Publik, Ekonomia Ndërkombëtare.

Doktor i Shkencave Ekonomike Teuta Nunaj është diplomuar në Universitetin e Tiranës dhe ka marrë titullin Financiere-Kontabiliste; është diplomuar në Universitetin Europian të Tiranës për Master Profesional në Menaxhim Biznesi dhe për Master Profesional në Marrëdhënie me Publikun. Në kuadër të projektit Erasmus +, përgjatë studimeve doktorale ka kryer një semester pranë Universitetit të Varshavës, Poloni.

Dr. Nunaj ka marrë gradën Doktor i Shkencave Ekonomike, me profil Menaxhim në vitin 2017. Ka një përvojë të gjatë profesionale si drejtuese, pedagoge dhe publiciste.

Dr. Nunaj ka marrë pjesë në konferenca ndërkombëtare në rajon dhe në vendet e OECD-së dhe ka publikuar artikuj të ndryshëm shkencorë në revista shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare.

Dr. Nunaj ka shkruar mbi 70 analiza në shtypin e shkruar në Shqipëri, rajon, Britaninë e Madhe, si dhe mbi 40 intervista televizive.

Dr. Nunaj ka gjithashtu një përvojë të gjatë akademike si pedagoge e lëndëve të: Menaxhim Operacional, Menaxhim Strategjik, Vendimmarrja, Menaxhim Strategjik i Burimeve Njerëzore, Biznesi Ndërkombëtar, Ekonomia Ndërkombëtare dhe Politika Publike.

Prej janarit 2016 Dr. Teuta Nunaj është pjesë e srafit akademik të SHLUJ “Universitetit Main Barleti”.